

# KLP emëron 3 prokurorë në Prokurorinë e Posaçme (SPAK)

POSTED 19/05/2020 KLP



Këshilli i Lartë i Prokurorisë zhvilloi sot mbledhjen plenare të radhës në prani të të gjithë anëtarëve, përfaqësuesëve të Ministrisë së Drejtësisë si dhe misionëve ndërkombëtare EURALIUS dhe OPDAT, e cila përmbylli fazën e procesit të pikëzimit për renditjen e kandidatëve për prokuror pranë Prokurorisë së Posaçme.

Në respektim të masave të ndërmarra për parandalimin e virusit Covid-19, mbledhja është mbajtur përmes platformës on-line.

Pasi u njoh me raportin përfundimtar për secilin prej 4 kandidatëve në garë të paraqitur nga kryetari i Komisionit të Posaçëm, z. Sandër Beci, bazuar në dokumentacionin e dorëzuar pranë këtij komisioni dhe intervistave të zhvilluar një ditë më parë, Këshilli ka miratuar projekt –vendimin “Për miratimin e listës me renditjen e kandidatëve për prokurorë në Prokurorinë e Posaçme dhe emërimin e tyre në detyrë”.

Sipas pikëzimit, i pari në listë është renditur kandidati Sotir Kllapi me 174 pikë, Dritan Prençi me 171 pikë, Vladimir Mara me 168 pikë dhe Dorina Bejko me 158 pikë.

Në përfundim, Këshilli vendosi të emërojë si prokuror në Prokurorinë e Posaçme z. Sotir Kllapi, z. Dritan Prençi dhe z. Vladimir Mara për një mandat 9 (nëntë) vjeçar pa të drejtë riemërimi. Ky vendim hyn në fuqi në datën 21.05.2020, pas ceremonisë së betimit para Presidentit të Republikës dhe botohet në faqen zyrtare të Këshillit.

Me propozim të kryetarit z. Gent Ibrahimimi, Këshilli miratoi gjithashtu listën e prokurorëve të cilët do të marrin pjesë në trajnimet e organizuara nga Shkolla e Magjistraturës për periudhën Prill-Qershor 2020, me fokus formimin e tyre profesional.